



Nr. 4635/1 Prot  
21.08.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 532 prot.

Shkodër, më 21.08.2024

**Lënda:** Mbi vendimin nr. 55, datë 29.07.2024 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 28, neni 40, neni 54, shkronja “dh”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë” i ndryshuar, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të VKB Vau Dejës nr. 91, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, të ndryshuar, sipas shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 4629 prot., datë 02.08.2024 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 29.07.2024”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 55, datë 29.07.2024 “Për një ndryshim në VKB nr. 91, datë 21.12.2023 Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 dhe numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

  
**Majlinda ANGONI**  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA VAU DEJËS**  
**KESHILLI BASHKIAK**  
**VENDIM**

Nr. 55 Datë 29 / 07 /2024

Për:

**“ Ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 29 . 07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenet 34-37, 40, 41, **54 shkronja “dh”** të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “i ndryshuar; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar , ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgaditjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”: Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Ligji 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, VKB nr 91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot. Datë 09.01.2024, Udhëzimit Plotësues nr 1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2024-2026, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
  - i . Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 05 (të ardhura), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2024-2026, të ndara në korente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar).

**SEKRETARI I KESHILLIT**

**Ardian ÇELEPLIA**

Miratuar me...16...vota

Vota pro 16.

Vota kunder .....

Vota Abstenim .....

Zbardhur me date 01 . 08.2024



**KRYETARI I KESHILLIT**

**Ervis SHIMAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 3588 Prot

Vau Dejës, më 04.06.2024


**Lënda:** Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për “**ndryshimin e vkb nr 91 datë 21.12.2023 “miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, për Bashkinë Vau Dejës”**

Duke ju uruar punë të mbarë!

Konceptoi: Renado Doda 

Miratoi: Elsa Tanushi



**KRYETAR**  
**Kristian SHKRELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 6, datë 04.06.2024

“PËR

**NDRYSHIMIN E VKB NR 91 DATË 21.12.2023 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024 – 2026, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika”1.3, nenet 34-37, 40, 41, **54 shkronja “dh”** të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”; **neni 44** i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligji 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", VKB nr 91 datë 21.12.2023 ‘Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës’, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot datë 09.01.2024, Udhëzimit Plotësues nr 1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës ,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetin të vitit 2024 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2024 - 2026, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
  - a) Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 05 (të ardhura), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2024-2026 , të ndara në korente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Kristian SHKRELI**



*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar*

*Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Integritetit dhe Aseteve*

Institucioni: Bashkia Vau Dejës  
Tabela Nr 1: "Rishperndarje e buxhetit ndermjet programeve te Kap 05".

Në Lekë

PAKËSOHET

Entit. i Qev.	Min. e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2024	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	04	04130	2310000	3333	1570778	445,695.00	TVSH per shpenzime kapitale per bashkefinancim me projektin "Vau Dejes si nje destinacion Turistik"
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	04	04130	6020000	3333	1570779	1,976,579.00	TVSH per shpenzime Operative per bashkefinancim me projektin "Vau Dejes si nje destinacion Turistik"
<b>SHUMA TOTALE</b>										<b>2,422,274.00</b>

SHTOHET

Në Lekë

Entit. i Qev.	Min. e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2024	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04130	2310000	3333	1570778	445,695.00	TVSH per shpenzime kapitale per bashkefinancim me projektin "Vau Dejes si nje destinacion Turistik"
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	04130	6020000	3333	1570779	1,976,579.00	TVSH per shpenzime Operative per bashkefinancim me projektin "Vau Dejes si nje destinacion Turistik"
<b>SHUMA TOTALE</b>										<b>2,422,274.00</b>

Nëpunësi Zbatues  
Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues  
Kristian Shkrelli



## RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

“PËR

**NDRYSHIMIN E VKB NR 91 DATË 21.12.2023 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2024 – 2026, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.**

### **QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2024 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot datë 09.01.2024, duke plotësuar nevojat e bashkise

Me zbatimin e buxhetit te vitit 2024 kanë lindur nevoja të përmirësohet funksionimi i bashkisë në zbatimin e marrëveshjes që ka për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare duke ndryshuar kapitulli i “TVSH per shpenzime kapitale per bashkefinansim me projektin"Vau Dejes si nje destinacion Turistik" dhe “TVSH per shpenzime Operative per bashkefinansim me projektin"Vau Dejes si nje destinacion Turistik", duke u ndryshuar nga Kapitulli 04 (TVSH) ne Kapitullin 05 (Të ardhura).

Sipas udhëzimit nr. 35, datë 21.9.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare” i ndryshuar pika 5.5 “Pavarësisht nga skemat e përdorura të thesarit, një pjesë e projekteve me financim të huaj janë në bashkëfinansim me Buxhetin e Shtetit, nga i cili përfitojnë fondet për TVSH-në, si dhe për kosto lokale. Këto shpenzime regjistrohen në strukturat përkatëse përgjegjëse për buxhetin, në zërin investime (me kod të ndryshëm të burimit të financimit përkatësisht: kapitulli 3 “Kosto lokale” dhe kapitulli 4 “TVSH”) dhe veprohet njëllor si shpenzimet e tjera buxhetore të këtij klasifikimi. Pagesat kryhen duke transferuar përkatësisht mjetet monetare nga llogaria e unifikuar e thesarit në llogaritë bankare të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e TVSH-së, si dhe të operatorëve ekonomike etj”. Por duke qënë se nga kalimi që është bërë për këto tvsh në kapitullin 04, është dashur të planifikohen që në fillim keshet për këto TVSH (që në momentin e lidhjes se marrëveshjes) sepse futen te shpenzimet e kesheve të kapitullit 01 (Transfertat e buxhetit të shtetit), atëherë ne duhet ti kalojmë në kapitullin 05 (Të ardhurat e bashkisë), në mënyrë që të kryhen pagesat e tvsh-ve të faturave të operatorëve ekonomike sipas marrëveshjes në fuqi që është bërë ndërmjet bashkisë dhe bashkimit europian, për të cilen bashkia ka rënë dakord të paguajë tvsh-të e faturave të operatorëve ekonomikë me të ardhurat e veta.

Nëpërmjet projekvendimit synohet parashikimi për një buxhet ambicioz, duke çuar në mirëfunksionimin e administratës vendore, duke synuar nivelin e duhur të përmirësimit të infrastrukturës së shërbimeve, dhe në fokus të jenë investimet në infrastrukturë dhe shërbimet publike për vitin 2024.

Procesi i rishikimit të buxhetit ka qenë i kujdeshem, i studiuar dhe i mirëmenduar se ku do të mbështetet Bashkia për të përballuar çdo situatë të mundshme. Menaxhimi të financave publike në nivel vendor është nën zbatimin e Ligjit nr. 68, datë 27.04.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore. Projektvendimi për miratimin e rishpërndarjes së buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024 vijon të mbështesë politikën e ndermarra nga pushteti vendor, e kryesuar nga vëmendja për ruajtjen e nivelit ekonomik vendor, dhe nëpërmjet saj përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit, dhe vijueshmërinë e investimeve kapitale në shërbimet publike dhe në infrastrukturë.

Këto ndryshime do të bëjnë të mundur përmirësimin e fushave kryesore aktuale, duke rregulluar balancat, rritur shërbimin dhe duke rritur funksionin që ka bashkia për sektorë të ndryshëm në territorin e saj

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar,

Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar

Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,

Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; Ligji 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022",

Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"

Vendim i Këshillit Bashkiak nr 91 prot me datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshmërie nga Prefektura Shkodër me nr 2/1 prot dhe datë 09.01.2024.

Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit 2024".

Udhëzim nr. 34, datë 5.12.2019 për një ndryshim në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 "për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë", i ndryshuar

Sipas udhëzimit nr. 35, datë 21.9.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", i ndryshuar.

Konceptoi: Renado Doda

Miratoi: Elsa Tanushi



**KRYETAR**  
**Kristian Shkreli**

